

Fino e gatshme me përmbajtje silikate-silikoni, në trajtë brumi Shtresë me sipërfaqe të lëmuar • e bardhë ose me ngjyrë • me aftësi ujëlarguese

Përshkrimi

MARMOCRYL SILICATE Fine është një suva i gatshëm akrilik me përmbajtje silikoni, i bardhë ose me ngjyrë, me aditivë të veçantë silikoni. Përbëhet nga materiale inerte të bluara me madhësi të veçantë të grimcave, për të krijuar një sipërfaqe dekorative me thurje të lëmuar. Ajo ofron avantazhet e mëposhtme:

- Elasticitet të lartë dhe ngjitje të shkëlqyer me nënshtresën.
- Largim të plotë të ujit.
- Përshkueshmëri të shkëlqyer të avujve të ujit me rezultat frumëmarrjen maksimale të ndërtesës.
- Nuk është më e nevojshme lyerja e fasadës.
- Rezistencë ndaj lëndëve alkaline sipas DIN 18556.
- Parandalim të plasaritjeve, ndryshe nga suvaja e zakonshme me çimento dhe gëlqere.
- Thjeshton dhe përshejton përdorimin.
- Përshtatshmëri për përdorim në mjedise të brendshme dhe të jashtme.

Është certifikuar me shënjen CE sipas EN 15824.

Fushat e përdorimit

MARMOCRYL SILICATE Fine përdoret si dora e fundit në punët e suvatimit, për të krijuar një shtresë sipërfaqësore finale të bardhë ose me ngjyrë, me aftësi ujëlarguese dhe me përbërje të ashpër (shtresë e hollë). Mund të aplikohet në të gjitha llojet e materialeve të ndërtimit, si suva, beton, pllaka çimentoje, pllaka gipsi etj. E përshtatshme për përdorim në ambiente të jashtme dhe të brendshme. Zvëndëson dorën e fundit të suvasë.

Për shkak të elasticitetit të lartë dhe ngjitjes së shkëlqyer me nënshtresën, ajo mund të përdoret gjithashtu si shtresë ideale finale për fasadat e jashtme me termoizolim.

Të dhënat teknike

Trajta:	në formë brumi
Ngjyra:	e bardhë dhe 1024 ngjyra të zgjedhura (ISOMAT COLOR SYSTEM)
Densiteti:	1,80 ± 0,03 kg/lit
Përshkueshmëria nga avujt:	V1 (EN ISO 7783-2, V1: E lartë Sd<0,14m)
Përçueshmëria nga uji:	W2 (EN 1062-3, W2: Mesatare 0,1<w< 0,5 kg/m ² h ^{0,5})
Forca ngjitetëse:	0,4 MPa (EN 1542)
Përçueshmëria termike:	λ=0,7 W/(m · K) (EN 1745)
Reagimi ndaj zjarrit:	Euroclass C (EN 13501-1)
Koha e tharjes:	4-6 orë (23°C dhe 50% R.H.)
Pastrimi i veglave:	Veglat duhet të pastrohen me ujë pas përdorimit.

Llojet në dispozicion

MARMOCRYL SILICATE Fine ofrohet në llojet e mëposhtme (sipas madhësisë të kokërrave):

Lloji	Trashësia e aplikimit
MARMOCRYL SILICATE Fine 1 mm	reth 1 mm
MARMOCRYL SILICATE Fine 1.5 mm	reth 1,5 mm
MARMOCRYL SILICATE Fine 2 mm	reth 2 mm

Konsumi

Reth 1,6 kg/m²/mm.

Udhëzimet e përdorimit

1. Nënshtrësia

Sipërfaqja duhet të jetë e thatë dhe pa pluhur, materiale me vaj ose pa materiale të lira. Pas kësaj bëhet lysterja me astar duke përdorur astarin special SILICONE-PRIMER. Sipërfaqet e lëmuara dhe jo thithëse duhet të lyhen me PL-BOND. MARMOCRYL SILICATE Fine aplikohet pasi është tharë shtresa e astarit të përdorur.

2. Përdorimi

MARMOCRYL SILICATE Fine duhet të trazohet mirë plotësisht përpara përdorimit. Kjo bëhet me lëvizje të ngadalshme ciklike për të shmangur krijimin e filluskave në masa e materialit. Suvaja aplikohet me dorë duke përdorur një shpatull të lëmuar metalike prej inoksi ose aplikohet me një makineri suvatuese. Kur është ende e njomë (mbas reth 20 minutash), suvaja trajtohet (ngjeshet) me përdaf plastik.

Koha e punës varet nga aftësia thithëse e nënshtrësës dhe temperatura e ambientit.

Amballazhimi

MARMOCRYL SILICATE Fine ofrohet në enë plastike 25 kg.

Shelf-life - Storage

Afati i ruajtjes për përdorim në enë plastike të izoluar dhe në ambiente të mbrojtura nga ngrica dhe dielli, me temperatura ndërmjet +5°C dhe +35°C, është minimumi 18 muaj.

Remarks

- Kokërrat natyrale që përdoren në suvaja mund shkaktojnë ndryshime të vogla në ngjyrë. Për këtë arsye dhe për të arritur një rezultat uniform ngjyre, rekomandohet që produkti të jetë nga i njëjti grup prodhimi ose të përziehen grupet e ndryshme. Gjithashtu, ngjyra përfundimtare mund të influencohet nga temperatura e nënshtrësës dhe nga lagështia
- Temperatura gjatë aplikimit duhet të jetë nga +5°C deri në +35°C.
- Ndërsa është ende i njomë, MARMOCRYL SILICATE Fine duhet të mbrohet nga temperaturat e larta, nga shiu dhe nga ngrica.
- Shikoni rreziqet e përdorimit dhe këshillat për sigurinë që janë të shkruara mbi thes.

Përbërësit organikë të avullueshëm (VOC)

Sipas Direktivës 2004/42/KE (Shtojca II, tabela A), përmbajtja maksimale e lejuar e VOC-së për produktin e nënkategorisë "c", lloji WB është 40g/l (2010) për produktin e gatshëm për përdorim.

Produkti i gatshëm për përdorim MARMOCRYL SILICATE Fine përmban maksimumi 40 g/lit VOC.



ISOMAT S.A.

17th km Thessaloniki – Ag. Athanasios
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece

13

EN 15824

External render based on organic binder

DoP No.: Marmocryl Silicate Fine/1412-01

Water vapor permeability: V1

Water absorption: W2

Adhesion: 0.4 MPa

Durability: NPD

Thermal conductivity: $\lambda = 0.7 \text{ W/(m} \cdot \text{K)}$

Reaction to fire: Euroclass C

ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:

17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 722 475

www.isomat.eu e-mail: info@isomat.eu

Informacioni teknik dhe udhëzimet e dhëna në këtë fletë të dhënash bazohen në njohurinën dhe në planin e Departamentit të Kërimit dhe të Zhvillimit të kompanisë sonë dhe në rezultatet e dalura nga përdorimet afatgjata të produktit në praktikë. Rekomandimet dhe sugjerimet që i referohen përdorimit të produktit jepen pa garanci, meqenëse kushtet e terraveve gjatë përdorimeve të tij janë prirje mundësisë së kontrollit të kompanisë sonë. Si rrjedhojë, përdoruesi është përgjegjës për të konfirmuar se produkti i zgjedhur është i përshtatshëm për përdorimin e parashikuar. Botimi aktual i kësaj flete të dhënash teknike anulon automatikisht çdo botim të kaluar që lidhet me të njëjtin produkt.

